



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 11.3.2025

Nr: 256

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË MINISTRIT TË SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT, PËR PERIUdhËN 23 SHKURT-1 MARS 2025**

Sot, më datë 11.3.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

- SUBJEKT:** Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit  
**OBJEKT:** Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, për periudhën 23 shkurt-1 mars 2025  
**BAZA LIGJORE:** Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Gjatë periudhës 23 shkurt 2025-1 mars 2025, **Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit**, ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari, jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- “Vizitë në ambientet e kompanisë “Green Panel”, me synimin për të zhvilluar një dialog të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e biznesit. Kjo vizitë organizohet në kuadër të angazhimit të Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit për të njohur nga afër realitetin e sipërmarrjeve në vend, duke identifikuar sfidat me të cilat ato përballen dhe duke promovuar

Data: 11.3.2025 Nr: 256  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit për periudhën 23 shkurt-1 mars 2025”

praktikat e suksesshme të biznes bërjes”, raportuar në datë 1.3.2025 për t’u zhvilluar në datë 5.3.2025.

Nëpërmjet postës elektronike, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Ministrin të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Ministrin të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit ka dërguar pretendimet, duke sqaruar si vijon: *“Lidhur me eventin që ishte ndaluar në regjistrim për shkak të afatit kohor, ju informojmë se kemi shtyrë datën e realizimit dhe e kemi regjistruar sërish vizitën në biznes në datën 3 mars 2025, duke deklaruar realizimin e saj më 9 mars 2025. Duke qenë se në portal nuk kemi mundësi ta anulojmë eventin e mëparshëm, pasi është ndaluar në deklarim, kemi vijuar me regjistrimin e aktivitetit sipas agjendës së re”*.

Për sa më sipër, pasi u njoha me arsyet e paraqitura nga ana e personit përgjegjës për raportimet, vlerësoj se veprimtaria publike e raportuar nga Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, nuk përbën shkelje sipas parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Pasi veprimtaria kanë marrë shënimin e ndaluar, aktiviteti nuk është zhvilluar, por është shtyrë dhe riraportuar për një datë tjetër, duke respektuar afatin 5 ditor të raportimit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, nenit 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Ministrin të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
2. Ky vendim njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**